

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7997
E premte, 21 shkurt 2025
Çmimi 0.50 €

Kurti nuk tregon
a do t'i përgjigjet urdhrit
të gjykatës | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NUMËRIMI I VOTAVE, DREJT FUNDIT

FAQE 4-5




Numërimi i votave të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit po shkon drejt përfundimit, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka filluar publikimin e

rezultateve. Janë procesuar 90.41 % e vendotimeve nga votat e numëruara për kandidatët e partive politike. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka bërë me dije se votat

me kusht, votat e personave me nevoja të veçanta dhe votat nga jashtë do të numërohen gjatë ditëve në vazhdim në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve

AKTUALE



KAOSI DIGJITAL PRAPA ZGJEDHJEVE NË KOSOVË F. 4

DIGJEN DISA LOKALE NË PRISHTINË

F. 6

OSMANI DISKUTON PËR ÇËSHJTJET E SIGURISË DHE ZGJEDHJET ME AMBASADORIN E SHBA-SË, TË GJERMANISË DHE TË BRITANISË F. 7

EKONOMI



SHËNOHET 36-VJETORI I GREVËS SË MADHE TË MINATORËVE TË VITIT 1989 F. 3

ME-ja HAP APLIKACIONET PËR ANKANDIN E ERËS, RIZVANOLLI PREMTON TRANSPRENCË F. 7

SPORT




'DARDANET' SYNOJNË FITORE NDAJ MAQEDONISË SË VERIUT F. 10

EURODEPUTETËT KËRKOJNË QË KOSOVA TË MOS MBETET ZONË GRI NË INTEGRIMIN EVROPIAN F. 2



SHTETET E BASHKUARA DHE KOSOVA: NGA NJË MARRËDHËNIE E VEÇANTË NË NJË MARRËDHËNIE MË TË NDËRLIKUAR F. 8

Elez BIBERAJ



RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Eurodeputetët kërkojnë që Kosova të mos mbetet zonë gri në integrimin evropian

PRISHTINË, 20 SHKURT - Shumica e deputetëve të Parlamentit Evropian që morën pjesë në diskutimet rreth draft-raporteve për Kosovën dhe Serbinë kërkuar që Bashkimi Evropian ta qartësojë procesin e integrimit të Kosovës në mënyrë që ky vend të mos mbetet një zonë gri në hartën e Evropës. Të enjten, në Komisionin e Politikës së Jashtme të PE-së, raportuesi për Kosovën, Riho Terras, paraqiti draft-raportin e tij vjetor për situatën në Kosovë dhe përparimin e saj drejt BE-së.

Gjatë debatit u shpreh pritja që Kosova ta konstitujë sa më shpejt Kuvendin, pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, dhe ta formojë qeverinë.

Ndërsa u kritikua mbajtja në fuqi e masave ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës, prej saj u kërkuar që ta mbajë fokusin në rajon, sidomos në Kosovë, në kohën e, siç u tha, rrethanave sfiduese në Evropë dhe në botë. Raportuesi Terras tha se pret që BE-ja të marrë rol më aktiv në Ballkanin Perëndimor dhe që Komisioni i ri Evropian dhe përfaqësuesja e lartë e tij, Kaja Kallas, të jenë në krye të këtij angazhimi.

Ai tha se BE-ja duhet t'i heqë masat ndaj Kosovës - që u ndërmorën në vitin 2023, për shkak të situatës së tensionuar në veriun e vendit të banuar me shumicë serbe - sepse ato, sipas tij, nuk janë korrekte.

Terras kërkoj që edhe pesë vendet e BE-së, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, ta bëjnë një gjë të tillë, në mënyrë që të përshpejtohet procesi i integrimit të Kosovës në BE.

Kosova është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që nuk është kandidat për anëtarësim në këtë bllok.

Raportuesi në hije nga Grupi Socialist dhe Demokrat, Elio Di Rupo, i cili ishte edhe vëzhgues i zgjedhjeve në Kosovë, tha se procesi ishte i një cilësie të lartë, me standarde të larta. Ai tha se mediet në Kosovë janë duke u përballur me sfida dhe se duhet të ketë më shumë përparim edhe në luftën kundër korrupsionit.

Di Rupo tha se raportet mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, janë të vështira për shkaqe historike. Ai tha se Kurti ishte i burgosur nga regjimi i Serbisë, por shtoi se kjo duhet të tejkalohet, në mënyrë që dialogu për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre të ecë përpara.

Nathalie Loiseao foli në emër të Grupit të Liberalëve dhe mbështeti tekstin e draft-



raportit.

Loiseao ishte shefe e vëzhguesve të BE-së në zgjedhjet e 9 shkurtit në Kosovë. Ajo kërkoj që dialogu mes Kosovës dhe Serbisë të ringjallet dhe që palët t'i zbatojnë obligimet e marra.

Edhe ajo tha se është domosdoshme që të gjitha vendet e BE-së ta njohin Kosovën dhe kërkoj që blloku ta sqarojë rrugën evropiane të Kosovës, në mënyrë që, siç tha, Kosova të mos mbetet një zonë gri.

Davor Ivo Stier, shef i delegacionit parlamentar për Kosovën, kërkoj heqjen e masave ndaj Kosovës, duke thënë se "kjo qasje e pabalancuar e BE-së ndaj Kosovës dhe Serbisë", sidomos pas sulmit në Banjskë në shtator të vitit 2023, e pengon përparimin në dialog.

Përfaqësuesi i Komisionit Evropian, Jiri Plecity, shef i njësisë për Kosovën dhe Serbinë në Drejtorinë e Zgjerimit, e përshëndeti zhvillimin e zgjedhjeve në Kosovë, por shprehu keqardhje për vonesat në numërimin e votave. Ai tha se pret që qeveria e re të formohet sa më parë, për të vazhduar me reformat dhe në normalizimin e raporteve me Serbinë.

Komisioni Evropian, në anën tjetër, pajtohet me pjesët kryesore të raportit.

Ai i mirëpriti veprimet e Kosovës për t'i tejkaluar pengesat që ishin paraqitur në Marrëveshjen për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore - CEFTA.

Zuzana Michalciva Sutiakova, si përfaqësuese e Shërbimit të Veprimit të Jashtëm të BE-së (EEAS), përmendi retorikën e ashpër gjatë fushatës zgjedhore në Kosovë dhe problemet me numërimin e votave, por tha se këto nuk duhet t'i vënë nën hije

pikat kryesore pozitive, që dëshmuar se Kosova ishte dhe mbetet demokraci funksionale. Ajo tha se këto zgjedhje do të duhej ta shënonin hapin e parë të kthimit të serbëve në institucionet e Kosovës. "Presim konstituimin e Kuvendit dhe të Qeverisë. Pas zgjedhjeve do të donim të shënonim një moment të ri në rrugën e Kosovës drejt BE-së. Siç janë shprehur edhe komisionarja [për Zgjerim] Marta Kos dhe përfaqësuesja e lartë, Kallas, ne jemi të gatshëm ta shqyrtojmë aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE sapo ta marrim një mandat për këtë nga Këshilli. Progresi në raportet me Serbinë është kusht i padiskutueshëm. Dialogu nuk ka alternativë", tha Michalciva Sutiakova.

As përfaqësuesja e EEAS-it, as ai i Komisionit Evropian nuk e përmendën heqjen e masave ndaj Kosovës, ndonëse kjo ishte ndër kërkesat më të shpeshta të deputetëve të Parlamentit Evropian.

Draft-raporti për Kosovën e vlerëson përkushtimin e Kosovës për integrim në BE. Në dokument thuhet se e ardhmja e Kosovës është në BE dhe se përpjekjet për ta nxjerrë vendin nga një zonë gri, janë në interes edhe të Kosovës, edhe të BE-së. Aty nënvizohet "progresi domethënës në fushën e drejtësisë, sigurisë dhe lirive, në luftën kundër krimit të organizuar dhe në funksionimin e ekonomisë së tregut", por shprehet keqardhje për "përparimin e limituar" në sundimin e ligjit.

Në draft-raport, edhe një herë, kërkoj nga BE-ja që t'i heqë masat ndëshkuese ndaj Kosovës, të cilat përfshijnë ngrirjen e disa fondeve dhe pezullimin e takimeve të nivelit të lartë. "Bëjmë thirrje për

heqjen e menjëhershme të masave të BE-së ndaj Kosovës, të cilat nuk janë më të arsyeshme dhe janë në kontradiktë me përkushtimin e dëshmuar të Kosovës ndaj vlerave evropiane dhe me përshtatjen e saj me politikën e BE-së", thuhet në dokument. Parlamenti Evropian mbështet edhe kërkesën e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe planin për t'iu bashkuar programit të Partneritetit për Paqe të NATO-s.

Në raport shprehet shqetësim për gjendjen jo të kënaqshme në Kosovë sa i përket korrupsionit dhe kërkoj që, pos reformave ligjore, të ketë edhe rezultate të dukshme në hetime dhe dënime të rasteve.

Shqetësim serioz shprehet edhe për dobësitë sistematike të sistemit të drejtësisë në Kosovë, sidomos sa i përket pavarësisë dhe respektimit të ndarjes së pushteteve. "Përsërisim shqetësimin për vonesat në rastet gjyqësore dhe kritikën nga ana e zyrtarëve të Qeverisë ndaj vendimeve në rastet individuale", thuhet në draft-raport.

Shqetësim shprehet, gjithashtu, për situatën e sigurisë në veri të Kosovës, posaçërisht pas sulmit të armatosur në Banjskë në shtator të vitit 2023, dhe sulmit në kanal in Ibër-Lepencit në nëntor të vitit 2024.

Raporti kërkon që kryesit e këtyre veprave të dhunshme, të nxirren para drejtësisë. Aty shprehet keqardhje përse Serbia nuk i ka nxjerrë para drejtësisë "kryesit e sulmit terrorist në Banjskë, përfshirë ish-nënkryetarin e Listës Serbe, Millan Radoiqiq".

Sa i përket gjendjes së mediave, raporti përmend ekzistimin e një mjedisi pluralist dhe nënvizon rolin e Komisionit të

Pavarur të Mediave, autonomia e të cilit "duhet të ruhet fuqishëm".

Në raport kërkoj me shumë transparencë sa i përket pronësisë dhe financimit të mediave, ndërsa shprehet shqetësim serioz për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve.

Dokumenti shpreh, gjithashtu, mbështetje për procesin e dialogut për normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë dhe përshëndet emërimin e Peter Sorensenit në postin e të dërguarit të posaçëm të BE-së për këtë dialog.

Serbisë i kërkoj të dëshmojë përkushtim ndaj integrimit në BE

Në këtë seancë të Komisionit të Politikës së Jashtme të Parlamentit Evropian u paraqit edhe draft-raporti për Serbinë, i përgatitur nga ana e raportuesit kroat, Tonino Picula. Në këtë dokument thuhet se Serbia duhet të dëshmojë me sjelljen e saj se është e përkushtuar vërtet për integrim në BE.

Asaj i kërkoj të respektojë edhe të drejtën e protestave paqësore dhe t'i ndërpresë akuzat ndaj vendeve të BE-së, se qëndrojnë prapa protestave të studentëve, të cilët kërkojnë përgjegjësi për vdekjen e 15 personave nga shembja e strehës në Stacionin Hekurudhor të Novi Sadit, nëntorin e kaluar.

Serbisë, po ashtu, i kërkoj progres në normalizimin e raporteve me Kosovën.

Picula, me këtë rast, kërkoj masa të shpejta ndaj kryesve të sulmit në Banjskë, përfshirë edhe ndaj Radoiqiqit.

Edhe përfaqësuesit e Komisionit Evropian, edhe ata të Shërbimit të Veprimit të Jashtëm nënvizuan se përparimi i Serbisë në negociatat për anëtarësim në BE, do të varet sidomos nga progresi në normalizimin e raporteve me Kosovën dhe në sundimin e ligjit.

Pas paraqitjes së këtyre draft-raporteve në Komisionin e Politikës së Jashtme të Parlamentit Evropian, deputetët do të kenë mundësi deri më 6 mars të paraqesin edhe amendamente në këto dokumente.

Për to, pastaj, do të votohet së pari në Komisionin Parlamentar nga fillimi i muajit prill, më pas edhe në seancë plenare, ku raportet do të miratohen si rezoluta të Parlamentit Evropian. (rel)

NUMËRIMI I VOTAVE, DREJT FUNDIT



Numërimi i votave të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit po shkon drejt përfundimit, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka filluar publikimin e rezultateve. Janë procesuar 90.41 % e vendvotimeve nga votat e numëruara për kandidatët e partive politike. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka bërë me dije se votat me kusht, votat e personave me nevoja të veçanta dhe votat nga jashtë do të numërohen gjatë ditëve në vazhdim në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka publikuar të enjten numrin e votave që kanë fituar kandidatët për deputetë të Kuvendit të Kosovës në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit pas numërimit të mbi 90 për qind të votave në vendvotime. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka bërë me dije se votat me kusht, votat e personave me nevoja të veçanta dhe votat nga jashtë do të numërohen gjatë ditëve në vazhdim në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. "Në këto rezultate janë përfshirë të dhënat nga 2 290 (90.41 %) nga 2 533 vendvotimet e numëruara deri më tani në Qendrat Komunale të Numërimit dhe se rezultatet e vendvotimeve të tjera do të publikohen në mënyrë progresive. Po në këto rezultate nuk përfshihen rezultatet e votave me kusht, votave të personave me nevoja të veçanta dhe votave nga votimi jashtë Kosovës, numërimi i të cilave do të bëhet gjatë ditëve

në vazhdim në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve", ka theksuar Elezi.

Sipas rezultateve, liderët e partive kryesore dhe kandidatët për pozitën e kryeministrit renditen kështu: Albin Kurti, lider i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidat për kryeministër – 259 532 vota; Bedri Hamza, kandidat për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës – 150 294 vota; Memli Krasniqi, lider i Partisë Demokratike të Kosovës – 85 293 vota; Lumir Abdixhiku, lider i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe kandidat për kryeministër – 109 202 vota; Ramush Haradinaj, lider i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe kandidat për kryeministër – 37 752 vota; Zllatan Ellek, lider i Listës Serbe – 9 354 vota.

Në rezultatet e publikuar nuk përfshihen votat me kusht, votat e personave me nevoja të veçanta dhe mbi 80 mijë vota nga diaspora.

Personi më i votuar në Kosovë vazhdon të mbetet presidentja aktuale e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila në zgjedhjet e vitit 2021 pati fituar 300 756

vota.

Dalja në zgjedhjet e sivjetme ishte 40 për qind - rreth 8 për qind më e vogël se në zgjedhjet e 2021-s.

Lëvizja Vetëvendosje (LV) - parti në pushtet - ka dalë e para në këto zgjedhje, me 40.80 për qind të votave, e pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 22.03 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 17.63 për qind të votave, koalicioni mes Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës Socialdemokrate ka marrë 7.46 për qind të votave, si dhe Lista Serbe 4.61 për qind të votave.

Partitë e tjera kanë fituar përqindje më të vogël të votave.

Me Ligjin e ri për Zgjedhjet, votat e kandidatëve për deputetë numërohen ndaras në Qendrat Komunale të Numërimit. Ky proces ka nisur me vonesë, ndërsa organizatat për monitorim të zgjedhjeve e kanë kritikuar vetë KQZ-në se nuk është përgatitur mjaftueshëm mirë për procesin.

Kush u ngjiti në krye të listës?

Dhjetë figurat më të votuara në Lëvizjen Vetëvendosje, pas Kurtit, janë: Glauk Konjuca me 199 136 vota, Faton Peci me 96 849 vota, Hekuran Murati me 94 531 vota, Albulena Haxhiu me 89 601 vota, Xhelal Sveçla me 85 632 vota, Donika Gërvalla me 79 691 vota, Avni Dehari me 68 735 vota, Mimoza Kusari - Lila me 61

945 vota dhe Arben Vitia me 48 760.

Nga radhët e PDK-së, pas Hamzës dhe Krasniqit, më të votuarit janë: Uran Ismaili me 37 017 vota, Vlora Çitaku me 34 805 vota, Sala Jashari me 32 052 vota, Përparim Gruda me 27 004 vota, Jakup Nura me 26 635 vota, Rrahman Rama me 25 532 vota, Nait Hasani me 24 162 vota dhe Elmi Reçica me 23 163.

Nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas Abdixhikut, më të votuarit janë: Doarsa Kica Xhelili me 44 738 vota, Hykmete Bajrami me 41 796 vota, Kujtim Shala me 37 886 vota, Avdullah Hoti me 30 932 vota, Anton Quni me 27 292 vota, Lutfi Haziri me 27 260 vota, Jehona Lushaku Sadriu me 22 122 vota, Armend Zemaj me 19 341 vota dhe Imri Ahmeti me 18 397 vota.

Në listën e koalicionit mes AAK-së dhe Nismës, pas Haradinajt, më të votuarit janë: Fatmir Limaj me 22 207 vota, Time Kadriaj me 12 976, Bekë Berisha me 12 972 vota, Ardian Gjini me 9 757 vota, Xhevahire Izmaku me 9 439 vota, Gani Bajraktari me 8 970, Albana Bytyqi me 8 398 vota, Besnik Tahiri me 8 006 vota dhe Pal Lekaj me 7 845 vota.

Nga kandidatët e Listës Serbe, më së shumti vota ka marrë Branislav Nikolliq nga Shtërpca, gjithsej 12 331 vota. Nikolliqi është vëllai i Bratisllav Nikolliqit, ish-kryetarit të komunës së Shtërpçës. Pas tij renditet Sërgjan Popoviq nga Gračanica me 11 329 vota të fituara, si dhe Lilana Stefanoviq nga Mitrovica e Veriut me 11 231 vota. Lilana Stefanoviq,

përndryshe, është ish-kryetare e Gjykatës Themelore në Mitrovicën e Veriut, e cila ka dhënë dorëheqje në kuadër të largimit kolektiv të serbëve nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022.

Bartësi i Listës Serbe, Zllatan Ellek, sipas rezultateve aktuale, është në vendin e shtatë për nga numri i votave të fituara – 9 354. Para tij, në vendin e katërt është Sllavko Simiq me 10 752 vota, në vendin e pestë Verica Çeraniq me 10 412 vota, ndërsa në vendin e gjashtë Igor Simiq me 10 391 vota të fituara.

Në vendin e tetë është Milana Nikolliq me 8 163 vota, në të nëntin Stefan Kovaçeviq me 7 635 vota, dhe në të dhjetin, Novak Zhiviq me 6 612 vota.

Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka siguruar më së shumti vota në këtë proces zgjedhor, është zotuar se do ta formojë qeverinë e re, ndonëse me rezultatet aktuale ajo nuk i ka 61 deputetë për miratim të kabinetit të ri qeveritar.

Analistët politikë kanë përmendur mundësinë e bashkimit të forcave të LV-së me komunitetet joserbe, që i kanë 10 ulëse të garantuara në Kuvend.

Partitë opozitare, PDK, LDK, dhe AAK, kanë hedhur poshtë mundësinë e krijimit të koalicionit me LV-në dhe kanë shprehur gatishmëri për formimin e një qeverie së bashku.

Njohësit e çështjeve politike paralajmërojnë se në ditët dhe javët në vijim Kosova rrezikon të përballet me turbulenca politike për shkak të thellimit të ndasive mes partisë në pushtet dhe atyre në opozitë.


Shënohet 36-vjetori i grevës së madhe të minatorëve të vitit 1989

Mitrovicë, 20 shkurt - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, kanë marrë pjesë në ngjarjen që shënoi 36-vjetorin e grevës së madhe

të minatorëve të vitit 1989 në Stan Tërg. "Në zemrën e Kosovës, në thellësinë e tokës sonë, prej dekadash rreh fuqia e një emri që simbolizon pasurinë, punën, qëndrueshmërinë dhe të ardhmen: emri 'Trepça', e nisi fjalën kryeministri Kurti. Ai the se

"Trepça" nuk është thjesht një ndërmarrje, "se ajo është shtylla e mijëra familjeve që çdo mëngjes mbështeten te puna e saj, duke krijuar një zinxhir që lidh të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen tonë ekonomike dhe jo vetëm".





KAOSI DIGJITAL PRAPA ZGJEDHJEVE NË KOSOVË

Sulmet e supozuara kibernetike në uebfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë kishin për qëllim ta minonin besimin në institucionet e Kosovës, të nxisnin trazira dhe të krijonin kaos politik, vlerësojnë ekspertët

PRISHTINË, 20 SHKURT - Sulmet e supozuara kibernetike në uebfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë kishin për qëllim ta minonin besimin në institucionet e Kosovës, të nxisnin trazira dhe të krijonin kaos politik, vlerëson profesori i Shkencave të Sigurisë në Kosovë, Avni Islami. "Realizimin e qëllimit të tyre e shmangën qytetarët e Kosovës", thotë ai, "duke mos rënë pre e ndërhyrjeve dhe dezinformatare". Në ditën e zgjedhjeve në Kosovë, më 9 shkurt, derisa pritej publikimi i rezultateve preliminare nga KQZ-ja, këtij institucioni i dështoi platforma elektronike. Ajo u kthye në funksion pas disa orësh, por edhe në ditët në vazhdim pati ndërprerje të kohëpaskohshme. Zëvendëskryeministri në detyrë i Kosovës, Besnik Bislimi, ngriti alarmin më 18 shkurt, duke thënë se siguria e shtetit të Kosovës u vu në rrezik nëpërmjet lajmeve të rreme dhe sulmeve kibernetike në uebfaqen e KQZ-së, si gjatë fushatës parazgjedhore, ashtu edhe në ditën e votimeve, më 9

shkurt. Për ndërhyrje në zgjedhje, po atë ditë, foli edhe ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, i cili e drejtoi gishtin nga Serbia. E pyetur nga "Radio Evropa e Lirë" se për çfarë sulmesh bëhet fjalë dhe nëse është hapur ndonjë rast, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit tha se "Prokuroria Themelore në Prishtinë ka autorizuar Policinë e Kosovës ta bëjë mbledhjen e informatare rreth mosfunksionimit të platformës online të KQZ-së, pas raportimeve për mosfunksionimin e saj". "Pra, tani jemi në fazën e mbledhjes së informatare dhe kryerjen e veprimeve të tjera, për të vërtetuar saktësinë e tyre", thuhet në përgjigje. KQZ-ja njoftoi qysh më 10 shkurt se i është drejtuar Prokurorisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera të sigurisë, lidhur me "problemet e mosfunksionimit të platformës për rezultatet preliminare". Policia e Kosovës nuk iu përgjigj kërkesës së "Radios Evropa e Lirë" për të komentuar në lidhje me

kërkesat e Prokurorisë, e as pyetjes se sa raste të veprës penale "hyrje në sistemet kompjuterike" janë regjistruar deri më tash këtë vit.

Ndërhyrje nga Rusia dhe Serbia

Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë theksoi në raportin e tij se dy media shtetërore ruse, RT Ballkan dhe Sputnik Serbia, publikuan rreth 60 artikuj për zgjedhjet parlamentare në Kosovë dhe se disa prej tyre kishin narrativë manipulimi kundër komunitetit serb. Në anën tjetër, ambasadori gjerman në Prishtinë, Rohde, tha se Serbia ndërhyri në zgjedhjet në Kosovë, duke kërkuar vota për Listën Serbe-partinë më të madhe të serbëve, të cilën e mbështet që nga themelimi i saj më 2013. Ende nuk është e qartë se sa deputetë i siguroi kjo parti në Kuvendin e Kosovës, pasi vazhdon numërimi i votave me kusht dhe i atyre nga diaspora.

Cili mund të ketë qenë qëllimi?

Profesor Islami beson se uebfaqja e KQZ-së ishte cak i sulmeve kibernetike, të cilat kishin për qëllim krijimin e një opinioni të mosbesimit të popullata e Kosovës ndaj institucioneve të saj, si dhe shkaktonin e trazirave në

vend. "Pra, në një anë, të supozoj se partia e parë [Vetëvendosje] ka manipuluar me zgjedhje dhe, në anën tjetër, të nixtej dalja në rrugë e përkrahësve të subjekteve të caktuara politike. Kësaj, do të krijohej një klimë e anarkisë dhe destabilizimit në përgjithësi", thotë Islami për "Radion Evropa e Lirë". Qëllimi, sipas tij, nuk u arrit, sepse qytetarët nuk ranë pre e, siç i quan ai, provokimeve. Islami shpreh bindjen se Kosova është cak i atyre që e kundërshtojnë pavarësinë e saj dhe orientimin e saj properëndimor. "Hakerët ose profesionistët që punojnë në këtë drejtim, gjejnë dritare ose zbrazëtira, përmes të cilave depërtojnë dhe i sulmojnë sistemet, sikurse ishte rasti i ueb-faqes së KQZ-së", thotë Islami.

Çfarë është sulmi kibernetik?

Sulmi kibernetik nënkupton përpjekjet e hakëreve për të fituar qasje të paligjshme në një kompjuter ose sistem kompjuterik, me qëllim të shkakimit të dëmit. Sulmi i tillë mund ta bëjë rrjetin kompjuterik të paqasshëm dhe, në këtë mënyrë, bllokton punën e institucioneve, korporatave apo bizneseve. Pasojat mund të jenë të rënda - nga humbja e të dhënave deri te dëmtimi i infrastrukturës kritike dhe ndikimi negativ në

ekonominë dhe sigurinë e një vendi.

Çfarë sigurie kibernetike ka Kosova?

Kosova ka Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2023-2027. Aty thuhet se vendi "do të krijojë mjedis online të sigurt dhe të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët, bizneset dhe qeverinë, duke punuar në zvogëlimin e dobësive dhe zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve, për të trajtuar çështjet e sigurisë kibernetike duke parandaluar dhe minimizuar dëmet". Kjo, sipas strategjisë, synohet të arrihet përmes punës në kornizën ligjore dhe metodave për t'i identifikuar të gjitha entitetet kritike të infrastrukturës së informacionit. Kastriot Fetahaj, inxhinier i sigurisë kibernetike dhe zhvillues i softuerit për kompaninë amerikane The Daily Wire, thotë se siguria kibernetike në institucionet e Kosovës vazhdon të jetë e brishtë, për shkak të kapaciteteve të kufizuara ose fare teknike dhe humane. Përkundër Ligjit për sigurinë kibernetike që i hapi rrugë themelimit të Agjencisë për Siguri Kibernetike, Fetahaj kujton se kjo agjenci nuk është themeluar as sot e kësaj dite. Zyrtarë të Ministrisë së Brendshme të Kosovës i thanë "REL"-it se, në dhjetor të vitit të

U pyet se a do t'i përgjigjet urdhrin të Gjykatës, Kurti nuk deklarohe

PRISHTINË, 20 SHKURT - Në Stan Tërg është mbajtur të enjten manifestimi qendror i Javës së Minatorëve, ndërkaq i pranishëm ishte edhe kryeministri i vendit, Albin Kurti. Ai pas vizitës atje u pyet nga gazetarët nëse do t'i përgjigjet urdhrin të gjykatës për dëshmi lidhur me rastin e rezervave shtetërore, por nuk u deklarua. "Urime java e

minatorëve!", tha shkurt Kurti, duke anashkaluar pyetjen e gazetarëve. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka dorëzuar në Gjykatën Themelore kërkesën që kryeministri Albin Kurti të paraqitet në PSRK për ta dhënë dëshminë në cilësinë e dëshmitarit lidhur me rastin e rezervave shtetërore.

Lajmin e kishte konfirmuar për "Telegrafi"-n, Mirlinda Gashi, zëdhënëse e Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila pohoi se janë në shqyrtim të kërkesës. "Konfirmojmë se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special - ka pranuar kërkesën në fjalë nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, e

njëta është duke u shqyrtuar nga gjykata", ishte shprehur Gashi. Kryeministri Kurti është ftuar dëshmitar nga Prokuroria që ta japë versionin e tij lidhur me rastin e rezervave shtetërore për të cilin të dyshuar janë afaristi Ridvan Muharremi dhe zyrtarët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Irfan Lipovica dhe

Hafiz Gara. Prokuroria kishte ftuar tri herë me radhë kryeministrin Albin Kurti për intervistim, por nuk është u përgjigjur thirrjeve të prokurorisë. Kurti kishte deklaruar se prokurorët duhet të shkojnë dhe ta intervistojnë në zyrë, duke deklaruar se këtë praktikë e kanë bërë edhe më herët prokurorët.



Osmani diskuton për çështjet e sigorisë dhe zgjedhjet me ambasadorët e ShBA-së, Gjermanisë dhe Britanisë

Prishtinë, 20 shkurt - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë kësaj jave zhvilloi takime të ndara me përfaqësues të vendeve partnere, duke përfshirë të Ngarkuarën me Punë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të

Amerikës në Kosovë, Anu Prattipati, ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, si dhe ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Gjatë këtyre takimeve u diskutua për zhvillimet e

fundit në vend, përfshirë çështjet e sigorisë, fuqizimin e bashkëpunimit bilateral me shtetet respektive, ecurinë e procesit zgjedhor si dhe konstituimin e institucioneve pas certifikimit përfundimtar të rezultateve nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit.



kaluar, është hapur konkursi për kryeshef të kësaj agjencie, në mënyrë që të niste me themelimin dhe funksionalizimin e saj, por, sipas tyre, "konkursi ka dështuar, për shkak të mospërbushjes së kriterëve dhe specifikave".

Fetahaj thotë se siguria kibernetike në institucionet shtetërore çalon në "pikat fundore", që nënkuptojnë uebfaqet dhe shërbimet për informim dhe përdorim të gjerë.

Ai shton se në bazë të vërtetimit të tij në ueb-faqen e KQZ-së, ajo "ka qenë e infektuar nga data 7 shkurt

deri së paku më 13 shkurt" me virus, i cili është shpërndarë edhe te qytetarët e rëndomtë që i janë qasur asaj faqeje. "Kur i shohim këto parregullsi, qoftë te portali i numërimit të votave, qoftë te faqja zyrtare e KQZ-së, atëherë siguria [kibernetike] në institucione shtetërore, lë shumë për të dëshiruar", thotë Fetahaj.

Kjo siguri nuk mund të arrihet asnjëherë 100%, por për ta përmirësuar atë, ai thotë se institucionet duhet të investojnë shumë më tepër në infrastrukturë dhe pajisje, ta zgjerojnë stafin për siguri kibernetike dhe ta trajnojnë

atë. Po ashtu, thotë Fetahaj, pagat në institucionet shtetërore për ekspertët e sigorisë kibernetike janë tejet të ulëta në krahasim me sektorin privat dhe kjo është një prej arsyeve përse personat me ekspertizë në institucione private dhe ndërkombëtare, nuk kanë interes të punojnë në institucione shtetërore. "Mendoj se Qeveria e Kosovës duhet ta rikategorizojë sektorin e sigorisë kibernetike dhe sektorin e IT-së, t'i heqë nga shkallëzimi që parasheh Ligji i punës, për arsye se nëse vazhdojmë me këtë shkallëzim, gjasat për të pasur ekspertë që e

dinë dhe e kryejnë punën e vet ashtu siç duan institucionet shtetërore, janë minimale", thotë Fetahaj.

Sulmet kibernetike në të kaluarën

Kosova ishte cak i sulmeve kibernetike disa herë në të kaluarën. Në maj të vitit 2024, grupe hakerësh prorusë morën përgjegjësinë për disa sulme të tilla, të cilat i bllokuan përkohësisht disa uebfaqe qeveritare, përfshirë atë të Presidencës dhe Kryeministrisë. Qeveria e Kosovës konfirmoi

atëkohë se sulmet vinin nga "hakerët rusë", por nuk specifikoi se për kë saktësisht bëhej fjalë.

Në një raport që publikoi organizata Demokraci Plus në vitin 2022 thuhej se Kosova "është subjekt i dezinformimit nga aktorë malinj të huaj, si Rusia, Kina dhe Serbia". Atë vit, Kosova, por edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor regjistruan disa sulme të njëpasnjëshme kibernetike. Caqe ishin uebfaqet e institucioneve shtetërore, ndërsa prejardhja e sulmuesve u regjistrua në vende të ndryshme, përfshirë: Rusinë, Holandën, Lituanië e të tjera.

Prokuroria ngre aktakuzë ndaj dy të pandehurve për "spiunazh"

PRISHTINË, 20 SHKURT - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur të enjten aktakuzë kundër dy të pandehurve me inicialet B. Sh. dhe M. Q., nën dyshimin se e kanë kryer veprën penale të spiunazhit. I pandehuri M. Q. është përmendur edhe për dyshimet për kryerje të veprës penale "mbajtje në

pronësi, kontroll, ose posedim i paautorizuar i armëve". Të pandehurit janë arrestuar në qershor të vitit të kaluar në qytetin e Ferizajt, ndërsa mediet lokale në Kosovë patën raportuar se ata dyshohet se kanë spiunuar për Agjencinë serbe të Sigurisë dhe Informacionit

(BIA). Vetë BIA pati reaguar duke mohuar secilën lidhje me personat e arrestuar. Prokurori i rastit ka kërkuar nga gjykata që të pandehurve t'u vazhdohet masa e paraburgimit deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, e ata t'i shpallë fajtorë dhe t'i dënojë.



APELI VËRTETON DËNIMIN ME BURGIM TË PËRJETSHËM NDAJ KRIVAQËS

PRISHTINË, 20 SHKURT - Gjykata e Apelit e Kosovës ka vërtetuar dënimin me burgim të përjetshëm ndaj Dardan Krivaqës, i cili është shpallur fajtor për vrasjen e Marigona Osmanit. Në njoftimin e Apelit u tha se, përveç vërtetimit të dënimit të Krivaqës, që u gjet fajtor për veprën "vrasje e rëndë", është vërtetuar edhe dënimi me 15 vjet burgim ndaj Arbër Sejdiut, i dënuar për veprën "ndihmë në kryerje të vrasjes së rëndë".

Marigona Osmani ka qenë 18-vjeçare kur është vrarë, më 22 gusht të vitit 2021, në banesën e Krivaqës në qytetin e Ferizajt. Krivaqa dhe Sejdiu fillimisht ishin dënuar për vrasjen e Osmanit në gusht të vitit 2023 por, Apeli, pasi kishte pranuar disa ankesa të mbrojtjes, e kishte kthyer rastin në rigjykim. Më 26 shtator 2024 shkalla e parë e gjyqësorit shqiptoi dënimet ndaj dy të akuzuarve. Për këtë aktgjykim në Apel



kishin dërguar ankesa Prokuroria Themelore e Ferizajt, përfaqësuesit e të dëmtuarve dhe mbrojtësve të akuzuarve, por Apeli tha më 19 shkurt 2025 se ato ishin të pabaza.

Apeli tha se nuk gjeti shkelje të dispozitave të procedurës penale në mënyrë që të

anulohej aktgjykim. Po ashtu, në njoftim u tha se janë analizuar të gjitha provat e përdorura në gjykim dhe Apeli i ka vlerësuar si "të drejta, objektive dhe të ligjshme". "Sa iu përket pretendimeve ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji gjyqësor

konstaton se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit D. K. dhe A. S., kanë kryer veprat penale të lartcekura, për të cilat janë shpallur fajtorë", u tha në

njoftimin e Gjykatës së Apelit. Po ashtu, Apeli tha se nuk ka gjetur shkelje të ligjit sa i përket lartësisë së dënimit të shqiptuar nga Gjykata Themelore e Ferizajt. Sipas aktakuzës, Krivaqa, më 21 gusht 2021, rreth orës 10:14, në banesën e tij, pa pëlqimin e tani të ndjerës Marigona Osmani, e ka detyruar atë të kryente marrëdhënie seksuale dhe e kishte abuzuar e maltretuar në formë të ndryshme. Sipas aktakuzës, një ditë më pas, më 22 gusht 2021, Krivaqa dhe Sejdiu e kanë vrarë të ndjerën në përpjekje për ta fshehur veprën penale të dhunimit.

Krivaqa e Sejdiu e kanë dërguar trupin e pajetë të viktimës në spitalin e qytetit dhe më pas janë larguar në drejtim të panjohur. Ata, po ashtu, ishin akuzuar për kryerjen e veprës së dhunimit, por u shpallën të pafajshëm për shkak të mungesës së provave.

USHTARËT E KFOR-it MARSHOJNË NË KAMPIN BONDSTEEL

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ushtarët e kombeve të ndryshme, të caktuar në Komandën Rajonale në Lindje të misionit të KFOR-it të udhëhequr nga NATO, u bashkuan për një marshim në kampin Bondsteel në Kosovë. Kështu u bë me dije përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" nga faqja e KFOR-it. Më tutje thuhet se ky trajnim i mundëson KFOR-it të jetë më i fortë së bashku, duke punuar për të siguruar një mjedis të sigurt për të gjitha komunitetet e Kosovës. "KFOR-i vazhdon ta zbatojë mandatin e tij - bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999 - për të kontribuar në një mjedis të sigurt dhe të sigurt



për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe lirinë e lëvizjes, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme. KFOR-i punon në koordinim të ngushtë me

Policinë e Kosovës dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në rolet e tyre përkatëse si reagues të sigurisë", thuhet në postim.

DIGJEN DISA LOKALE NË PRISHTINË

PRISHTINË, 20 SHKURT - Policia e Kosovës ka konfirmuar se në mëngjesin e së enjtes janë djegur disa lokale në rrugën "Ilaz Agushi" në Prishtinë. Kjo rrugë gjendet afër Tregut të Gjellbër.

Policia i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se në vendngjarje kanë dalë policia dhe zjarrfikësit. Nuk është raportuar për persona të lënduar.

Malë Gashi, ushtrues detyre i komandantit të Brigadës së Zjarrfikësve në Prishtinë, ka thënë për mediet se zjarri ka përfshirë gjashtë biznese - kafene, qebaptore, ato për shitje të pemëve dhe perimeve, si dhe të pajisjeve elektronike. "Dëmet janë të mëdha, por me to do të merren inspektorët për vlerësim", ka thënë ai.



Gashi ka thënë se nuk dihet ende shkaktari i zjarrit.

Në fundjavë është raportuar edhe për djegien e një hotel-restoranti në Brezovicë, ndërsa më herët gjatë këtij muaji ishte raportuar edhe për djegien e ndërtesës së një klubi nate në kryeqytet.

Policia pati thënë për mediet lokale se në koordinim me prokurorinë ka ndërmarrë veprime hetimore për t'i sqaruar rrethanat e rastit.

Konfiskohen 400 euro në Gjakovë, dyshohet se ishin të falsifikuara

GJAKOVË, 20 SHKURT - Policia e Kosovës ka njoftuar për një rast të falsifikimit të parasë në

Gjakovë. Sipas policisë, dyshohet se një klient i bankës ka depozituar dy

kartëmonedha nga 200 euro secila, të cilat dyshohet të jenë të falsifikuara. Kartëmonedhat

e dyshuara janë konfiskuar nga autoritetet dhe policia ka nisur hetimet.



ME-ja hap aplikacionet për ankandin e erës, Rizvanolli premton transparencë

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ministria e Ekonomisë të enjten ka bërë hapjen publike të aplikacioneve për ofertuesit e ankandit me erë. Gjatë hapjes publike të aplikacioneve të dorëzuar nga ofertuesit potencialë, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, është zotuar se do t'i ndjekë përsëri standardet më të larta të transparencës dhe konkurrencës për këtë sektor. Rizvanolli theksoi se ankandi i parë i erës, së bashku me atë

solar, do të plotësojnë, siç tha ajo, "mixin e energjisë elektrike të vendit". "Sot po shpalojmë aplikimet e pranuar bazuar në kërkesën për kualifikim për ndërtimin e implantit të erës prej 50 deri në 100 megavatesh në Kosovë. Përvoja e ankandit të parë solar prej 100 megavatesh jo vetëm që ngjall interesim, mirëpo edhe siguron çmimet e favorshme për konsumatorët tanë. Zotohemi që përsëri do t'i ndjekim standardet më të larta të transparencës dhe

konkurrencës", tha Rizvanolli. Ministrja shtoi se faza e dytë e aplikimit, kërkesa për propozime fillon gjatë muajit mars, ku kompanitë do të kenë mundësi të aplikojnë me propozime financiare për impiantin tonë të erës. "Ankandi i parë i erës bashkë me atë solar i cili është përfunduar do të plotësojë mixin tonë energjetik. Në këtë proces janë tri kompani ndërkombëtare dhe një vendore", tha Rizvanolli.



ÇMIMI I ARIT ARRIN NIVELIN MË TË LARTË TË TË GJITHA KOHËVE

WASHINGTON, 20 SHKURT - Çmimi i arit ka shkuar pranë 3 000 dollarëve për ons për shkak të blerjeve të shtuara nga bankat qendrore dhe shqetësimeve të investitorëve për rritjen ekonomike globale pas njoftimeve për tarifa të reja amerikane.

Në tregun fizik, çmimi i një onsi (28 gramë) ari rreth mesditës ishte 2 943 dollarë, duke u rritur 0.3 për qind krahasuar me mbylljen e djeshme të tregjeve. Për një moment arriti një nivel të ri rekord prej 2 946 dollarësh, që është hera e nëntë këtë vit që arrihet një kulm i ri që nga fillimi i vitit.

Në tregun amerikan të kontratave të së ardhmes ari u tregtua me një çmim 0.4 për qind më të lartë prej 2 961 dollarësh. Sipas llogaritjeve të Shoqatës Botërore të Ardhjes (WGC), çmimi i arit u rrit mbi 28 për qind vitin e kaluar për shkak të kërkesës së fortë nga bankat qendrore dhe investitorët gjatë periudhave të tensioneve të larta gjeopolitike. Bankat qendrore kanë vazhduar t'i mbushin rezervat edhe në vitin 2024, duke rritur ritmin e blerjeve në tetor, dhe pritjet të vazhdojnë këtë trend edhe në vitin 2025, sipas vlerësimeve të WGC në mes të dhjetorit.

Kërkesa për investime në ar u rrit gjithashtu për shkak të rreziqeve gjeopolitike dhe luhatjeve të forta në tregjet financiare rajonale.



Investitorët rifilluan blerjet në tremujorin e tretë të vitit pasi bankat qendrore nisën t'i ulnin normat kryesore të interesit, shkruan "Reuters".

Në fillim të këtij viti nervozizmi u shtua pas deklaratave të presidentit amerikan Donald Trump për tarifën doganore. Një ditë më parë Trumpi tha se planifikon të vendosë tarifa prej rreth 25-përqindësh për importet e makinave, si dhe tarifa të ngjashme për

gjysmëpërçuesit dhe produktet farmaceutike.

Tregtarët kanë frikë se këto tarifa mund të çojnë në një luftë tregtare dhe ta dëmtojnë ekonominë globale. "Duket se rritja e çmimit të arit është nxitur nga deklaratat e Trumpit për tarifën ndaj veturave dhe ilaçeve, që mund ta hapin rrugën për arritjen e nivelit prej 3000 dollarësh", tha analisti i tregut në OANDA, Zaid Wanda. Që kur u rikthye në Shtëpinë e

Bardhë, Trumpi ka vendosur tashmë një tarifë prej 10-përqindësh për importet nga Kina dhe një tarifë prej 25-përqindësh për importet e çelikut dhe aluminit nga vende të ndryshme të botës. "Mendoj se bankat qendrore do të vazhdojnë të blejnë ar dhe t'i diversifikojnë rezervat e tyre me ar, duke mbështetur kështu rritjen e çmimit të tij", tha analisti i UBS, Giovanni Staunovo.

Gjithashtu, çmimi i argjendit, i cili përdoret në komponentët elektrikë, u rrit 0.4 për qind, duke arritur në 32.99 dollarë për ons. Ndërkohë, platina, e cila përdoret në katalizatorët e automjeteve, ra me 0.6 për qind, duke u tregtuar në 981.56 dollarë. Ndërsa çmimi i paladiumit (metal i rrallë dhe i shkëlqyeshëm argjend-bardhë) mbeti pothuajse i pandryshuar, në 987.75 dollarë.

Ish-ministri i Ekonomisë në Maqedoninë e Veriut: Qytetarët po blejnë në Kosovë, se te ne rritja e çmimeve është e trefishtë

SHKUP, 20 SHKURT - Ish-ministri i Ekonomisë në Maqedoninë e Veriut nga radhët e BDI-së, Kreshnik Bekteshi, thotë se qytetarët po blejnë në Kosovë për shkak se inflacioni në Maqedoninë e Veriut është trefish më i madh.

Bekteshi tha se ka "kolaps të vërtetë" në pjesën e menaxhimit me rritjen e çmimeve. "Kemi të dhëna nga Enti Statistikor i

Maqedonisë së Veriut, të fundit, të janarit, ku pothuaj se kemi një kolaps të vërtetë në menaxhimin me inflacionin, edhe nëse krahasohemi me shtetet e rajonit e jo me shtetet e Bashkimit Evropian. Për shembull, në janar të këtij viti inflacioni në Republikën e Kosovës ka qenë 1.5 %, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në pjesën e produkteve

ushqimore dhe pijeve ka qenë mbi 5.5 %, që është trefish më e lartë se ajo që e kanë qytetarët në Republikën e Kosovës. Duke qenë fqinjë, me siguri që një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve tanë do ta shohin si mundësi ta vizitojnë më shumë Kosovën dhe atje të bëjnë blerje të ndryshme për nevojat familjare", ka thënë Bekteshi. (TV21)



Shtetet e Bashkuara dhe Kosova: Nga një marrëdhënie e veçantë në një marrëdhënie më të ndërlikuar

FJALA NË KONFERENCËN MBI MARRËDHËNIET E KOSOVËS ME SHTETET E BASHKUARA,
MBAJTUR NË UNIVERSITETIN "GEORGE WASHINGTON", MË 18 SHKURT 2025



Elez BIBERAJ

Shtetet e Bashkuara dhe Kosova kanë pasur një marrëdhënie të shumanshme dhe shumë të veçantë. Si çdo marrëdhënie dypalëshe, asimetrike, edhe kjo marrëdhënie ka kaluar nëpër faza të ndryshme, duke përfjetuar transformime të rëndësishme - nga periudhat e ndërveprimeve intensive, konvergencës së interesave, dhe një nivel të lartë bashkëpunimi dhe bashkërendimi të politikave, në një marrëdhënie më të ndërlikuar, e cila ndonjëherë është karakterizuar nga mosmarrëveshjet mbi çështje themelore. Shtetet e Bashkuara kanë qenë forca shtytëse për çlirimin e Kosovës, shpalljen e pavarësisë dhe konsolidimin e shtetformimit.

Administratat e njëpasnjëshme amerikane, republikane dhe demokratike, kanë ndjekur një politikë të qëndrueshme ndaj Kosovës. Vizioni i Amerikës për Kosovën ka qenë një vend i qëndrueshëm, i begatë dhe demokratik, me institucione të forta të pavarura, qeverisje të mirë, respekt për shtetin e së drejtës, respektimin e të drejtave të pakicave dhe marrëdhënie të mira me fqinjët. Për dekada të tëra, ShBA-ja është angazhuar në mënyrë të qëndrueshme për të ndihmuar Kosovën të përballet me sfidat e saj të brendshme dhe të

jashtme, duke nxitur qëndrueshmërinë dhe demokratizimin e saj dhe duke ofruar mbështetje të konsiderueshme diplomatike, politike, ekonomike dhe ushtarake. ShBA luajti një rol të drejtpërdrejtë dhe udhëheqës në sigurimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës. Përpjekjet e diplomacisë publike amerikane në emër të Kosovës ishin të rëndësishme në sigurimin e njohjes nga më shumë se 100 vende. Shtetet e Bashkuara luajtën gjithashtu një rol kyç në mbrojtjen e çështjes së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila vendosi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk shkelte të drejtën ndërkombëtare. Kosova gëzonte mbështetje të gjerë dypartiake dhe ishte në qendër të vëmendjes së nivelit të lartë. Udhëheqësit dhe zyrtarët kosovarë gëzonin qasje të pazakontë ndaj politikëbërësve kryesorë amerikanë. Në dekadat e fundit, ShBA ka dhënë rreth 2 miliardë dollarë ndihmë. Një kontingjent i trupave amerikane është pjesë e KFOR-it, i cili mbron sigurinë e Kosovës.

Nga ana e saj, Kosova ka qenë një aleat i vendosur amerikan, një partner i rëndësishëm në Ballkan dhe një mbështetës i veprimeve të politikës së jashtme amerikane. Ajo ka

ndarë objektivat amerikane për të kundërshtuar ndikimin rus dhe kinez dhe përpjekjet e tyre destabilizuese në rajon. Me kërkesën e Uashingtonit, ajo ka pranuar edhe refugjatët afganë. Kosova është padyshim vendi më pro-amerikan në Evropë. Shumë shqiptarë kanë arritur ne përfundim se marrëdhënien me Shtetet e Bashkuara janë të përhershme dhe vendimtare për mirëqenien e Kosovës.

Falë mbështetjes së Amerikës, Kosova është një histori suksesi. Ajo ka bërë përparim të ndjeshëm në konsolidimin e shtetit të saj, ka një rend demokratik funksionues, një ekonomi tregu dhe marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët e saj, me përjashtim të Serbisë. Kosova nuk ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga fqinjët e saj sa i përket qeverisjes, sundimit të ligjit, institucioneve të pavarura, mbrojtjes së pakicave, respektimit të të drejtave të njeriut, lirive të shtypit dhe mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta.

Përkundër këtij përparimi, Kosova është në fazë kalimtare. Sfidat më të madhe e saj është kërcënimi nga Serbia. Njëzet e pesë vjet pas përfundimit të luftës së vitit 1999, Beogradi vazhdon të minojë sovranitetin e Kosovës, duke mbështetur strukturat paralele në veri, duke

nxitur incidente të dhunshme dhe duke punuar kundër anëtarësimit të Kosovës në institucionet ndërkombëtare. Ndërsa bota ka ecur përpara, shqiptarët dhe serbët mbeten peng i së kaluarës së tyre të trazuar. Ata ende e shohin marrëdhënien e tyre si çdo fitore për njërën pale është humbje për palën tjetër. Me vizionet konkurruese të marrëdhënies së tyre, të dy palët nuk kanë arritur të marrin përgjegjësinë dhe të çojnë përpara procesin e pajtimit. Ndërsa Kosova kërkon njohjen nga Beogradi, Serbia përpiket për një ndarje de facto dhe deri tani ka kundërshtuar çdo zgjidhje që do të forconte sovranitetin e Kosovës. ShBA dhe BE kanë punuar ngushtë për të lehtësuar një dialog midis Prishtinës dhe Beogradit, duke trajtuar një sërë çështjesh me shpresën se në fund të procesit do të kishte një pajtim dhe Serbia do ta njohte Kosovën. Bisedimet e lehtësuara nga BE çuan në nënshkrimin e një sërë marrëveshjesh në 2013 dhe 2015, duke parashikuar integrimin e autoriteteve policore dhe gjyqësore në veri në sistemin e Kosovës, reciprocitetin e targave dhe, më e diskutuara, krijimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe.

Ndërsa disa nga marrëveshjet u

zbatuan, marrëveshja që kërkonte një asociacion të komunave me shumicë serbe shkaktoi mosmarrëveshje të mëdha. Pothuajse menjëherë, Beogradi dhe Prishtina ofruan interpretime të ndryshme të marrëveshjes.

Beogradi këmbëngul se asociacioni duhet të ketë fuqi ekzekutive - një vijë e kuqe për të gjitha forcat e mëdha politike në Kosovë. Shumë shqiptarë besonin se marrëveshja ishte me të meta dhe se procesi i dialogut ishte në thelb një përpjekje për të rin negociuar pavarësinë. Sipas tyre, ShBA dhe BE po e detyronin Prishtinën të bënte lëshime, ndërsa nuk ushtronin trysni dhe duhur ndaj presidentit Aleksandar Vuçiq për të njohur Kosovën.

Krijimi i Dhomave të Specializuara në Hagë ishte gjithashtu një çështje tepër polarizuese. Shqiptarët e shihnin themelimin e Gjykatës Speciale si një sulm ndaj sovranitetit të Kosovës dhe si një përpjekje për të barazuar krimet e Serbisë me krimet shqiptare. Padiat e presidentit Hashim Thaçi në qershor të vitit 2020, ndërsa ai ishte rrugës për në Shtëpinë e Bardhë për një takim me presidentin Trump dhe presidentin Vuçiq, u pa si nga mbështetësit dhe kundërshtarët e tij si një ngjarje tejet poshtëruese.

Qeveria e Kosovës u përball me sfida në rritje në balancimin e përparësisë së shtrirjes së autoritetit të saj në veri me thirrjet për të pranuar kërkesat serbe, të cilat synonin qartë pakësimin e sovranitetit të Kosovës. Udhëheqësit e Prishtinës nuk ishin në gjendje të propozonin një alternativë të besueshme për marrëveshjen e asociimit apo të zhvillonin një politikë koherente ndaj pakicës serbe. Ndërkohë, ata u përballën me situatën e paretshme ku ShBA, aleati i tyre kryesor, gradualisht, por me pamedyshje, po ndryshonte politikën e saj dhe, sipas tyre, po merre gjithnjë e më shumë anën e Serbinë. Shumë shqiptarë nuk mund ta kuptonin se si Uashingtoni nuk shfaqte mbështetje për qëndrimin e Prishtinës dhe se si fuqitë perëndimore, që kishin ndërmarrë fushatën ushtarake që çliroi Kosovën, nuk e shihnin Serbinë nëpërmjet prizmit të tyre. Por ShBA dhe aleatët e saj evropianë nuk e kishin parë kurrë Serbinë nëpërmjet prizmit të Kosovës dhe qëndrimi i tyre ndaj Kosovës ishte tani pjesë e një konteksti më të gjerë, rajonal. Presidenti Vuçiq ishte rehabilituar - vetëm shqiptarët kujtonin lidhjet e tij me regjimin e Millosheviqit - dhe tani shihej si një aktor i rëndësishëm për çështje të ndryshme. Pavarësisht mosmarrëveshjeve të shfaqura dhe momenteve të tensionit lidhur me bllokimin e bisedimeve me Serbinë, Prishtina bashkëpunoi ngushtë me Uashingtonin. Udhëheqës të lartë, si presidentët Thaçi, Fatmir Sejdiu, Atifete Jahjaga dhe kryeministrat Isa Mustafaj, Ramush Haradinaj dhe Avdullah Hoti mbështetën imazhin e lidhjeve të forta dhe bashkëpunimi vazhdoi të zgjerohet në të gjitha fushat. Pas zgjedhjes së tij si president, Hashim Thaçi vendosi që ai, në vend të kryeministrit, siç ishte praktika deri atëherë, të udhëhiqte bisedimet me Serbinë. Ky u bë një proces negociues shumë i personalizuar, dhe aktorë të tjerë vendor u mënjanuan. Pas një sërë takimesh me Vuçiqin, në verën e vitit 2018 Thaçi propozoi atë që ai e quajti si një "korrigjim kufijsh" me Serbinë. Plani i tij nxiti përçarje të brendshme dhe dallimet serioze u shfaqën midis Thaçit dhe kryeministrit Ramush Haradinaj, i cili e denoncoi presidentin si gërmuesin e rëndë të pavarësisë së Kosovës. Dialogu me Serbinë u ndërpre në dhjetor 2018, kur Haradinaj vendosi tarifa 100% për mallrat nga Serbia. Marrëdhënia e fortë dhe e gjithnjëshme e Kosovës me Shtetet e Bashkuara u provuan ashpër me ardhjen në pushtet të kryeministrit Albin Kurti. Kurti shënoi një fitore mbresëlënëse në zgjedhjet e vitit 2021, duke siguruar 58 nga 120 vende në parlament. Ai kishte një mandat më të fortë se çdo udhëheqës tjetër që nga pavarësia për të

marrë vendime të vështira në avancimin e procesit të pajtimit me Serbinë. Që në fillim, Kurti e bëri të qartë se dialogu nuk ishte në krye të agjendës së tij. Ai me ngurrim mori pjesë në bisedimet me Serbinë, por nuk u arrit shumë përparim. Në mars të vitit 2023, Kurti dhe Vuçiq pranuan një marrëveshje të ndërmjetësuar nga BE, e njohur si Marrëveshja e Ohrit, që synonte normalizimin e plotë të marrëdhënieve. Marrëveshja e Ohrit ofron një plan udhëzues për zbatimin e marrëveshjeve të mëparshme, parashikon një nivel të vetë-qeverisjes për pakicën serbe dhe njohjen reciproke të simboleve shtetërore. Marrëveshja nuk kërkon që Beogradi të njohë Kosovën, por ajo e pengon Serbinë të bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Ndërsa Vuçiq pranoi gojarisht marrëveshjen, ai refuzoi ta nënshkruante atë. Kryeministrja Ana Brnabiç më pas i dërgoi një letër Brukselit, duke deklaruar se Serbia nuk mund të zbatonte disa pjesë të marrëveshjes që nënkuptonte njohjen de facto nga Beogradi të Kosovës. BE këmbënguli se marrëveshja ishte detyruese dhe u kërkoi të dy palëve ta zbatonin atë. Kurti shprehu gatishmërinë për të nënshkruar marrëveshjen, por ai këmbënguli se Kosova nuk do të vazhdojë me zbatimin nëse Vuçiqi nuk nënshkruan gjithashtu marrëveshjen dhe nuk e tërheq letrën e Brnabiçit. Ndërkohë, gjendja në veri u përkeqësua, me një seri incidentesh të dhunshme. Anëtarët serbë të parlamentit, kryebashkiakët, gjyqtarët, prokurorët dhe policët dhanë dorëheqjen. Kurti u përgjigj duke ndërmarrë veprime për të integruar veriun në sistemin ligjor dhe administrativ të vendit. Ai çmontoi institucionet paralele, mbylli bankat serbe, mandatoi përdorimin e monedhës Euro dhe rriti praninë e forcave speciale të sigurisë. Kurti përdori një retorikë nacionaliste dhe pohoi se masat e tij kishin çuar në shtrirjen e sovranitetit të Kosovës. Veprimet e tij ishin popullore dhe u mirëpritën nga përkrahësit e tij dhe popullsia në përgjithësi, por ato i dhanë një goditje strategjike Kosovës. Pavarësisht kërkesave të përsëritura të zyrtarëve amerikanë dhe të BE-së për të bashkërenduar veprime të tilla të diskutueshme në veri, Kurti nuk arriti të tregojë ndjeshmëri ndaj ShBA-së, duke dëmtuar kështu seriozisht marrëdhëniet me aleatin më të rëndësishëm strategjik të Kosovës. Si ShBA ashtu edhe BE vendosën masa ndëshkuese ndaj Kosovës. Për ironi të fatit, mandati i Kurtit përkoji me atë të Joe Bidenit. Presidenti Biden ishte njohës i mirë i çështjeve shqiptaro-serbe dhe, si senator dhe zëvendës-president, ishte një nga mbështetësit më të fortë të Kosovës. Anëtarët e lartë të administratës së tij kishin luajtur

role të rëndësishme gjatë luftës së vitit 1999 dhe konsideroheshin miq të Kosovës. Në vend që të përfitonte nga këto marrëdhënie personale dhe qasja në shumicën e politikëbërësve të lartë, Kurti arriti të tjetërsojë disa nga mbështetësit më të flaktë amerikanë të Kosovës. Kurti nuk bëri përpjekje serioze për të mbrojtur dhe ndërtuar marrëdhënien më të rëndësishme të Kosovës. Ai i nënvlerësoi masat ndëshkuese të vendosura ndaj vendit të tij dhe mbajti iluzionin se marrëdhënia me Shtetet e Bashkuara ishte e paprekur. Ai gjithashtu nuk ndërmori ndonjë përpjekje të dukshme në rrafshin e diplomacisë publike për të shpjeguar qëndrimin e qeverisë së tij apo për të ofruar një alternativë të besueshme që mund të kishte qenë e pranueshme për Uashingtonin. Ndërsa përpjekjet e diplomacisë publike në vetvete nuk mund të kishin siguruar zgjidhje të favorshme për Prishtinën, ato mund të kishin kontribuar në zgjerimin e marrëdhënieve dhe një kuptim më të mirë të faktorëve në të cilët mbështetën politikën e Kosovës. Kjo ishte në kontrast me qasjen e ndjekur në të kaluarën nga udhëheqësit e Kosovës. Në vitet 1990, Ibrahim Rugova u angazhua në një fushatë të gjerë publike në Shtetet e Bashkuara, duke shpjeguar qëndrimet e Kosovës dhe duke bërë përpjekje për të siguruar mbështetje dhe për të forcur lidhjet. Ai arriti të ndërtojë marrëdhënie të vlefshme dhe të siguroi mbështetje për pozitën e Kosovës. Presidenti Rugova gjithashtu angazhoi bashkësinë e vogël, por me ndikim, shqiptaro-amerikane, e cila luajti një rol të madh në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe sigurimin e mbështetjes amerikane. Shqiptaro-amerikanët përdorën një shumëllojshmëri taktikash dhe mediash për të ndikuar tek zyrtarët kryesorë të politikës amerikane - në Shtëpinë e Bardhë, Këshillin e Sigurisë Kombëtare dhe Departamentin e Shtetit. Aktivistët e komunitetit siguruan gjithashtu mbështetje të rëndësishme në Kongres. Ligjvënësit e fuqishëm, si Përfaqësuesi Tom Lantos, Senatori Dennis DeConcini, Senatori Bob Dole, Senatori Joe Biden, Përfaqësuesi Elliott Engel, dhe të tjerë, u bënë mbështetës të fortë të Kosovës. Pas çlirimit, Rugova dhe udhëheqësit e tjerë kosovarë vazhduan në mënyrë krijuese angazhimet për të shtrirë mbështetjen e Kosovës në arënën politike dhe mediale amerikane. Sulmi brutal i Ukrainës nga Rusia në vitin 2022 shkaktoi një ndryshim të ndjeshëm të objektivave të politikës së jashtme amerikane në Ballkan. Administrata Biden u përqendrua në angazhimin e Serbisë në kontekstin e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës. Edhe pse Serbia nën presidentin Vuçiq e kishte

minuar vazhdimisht procesin e negociatave me Kosovën, qëndrimet amerikane ndaj Serbisë u zhvendosën në mënyra që minuan pozitën e Kosovës. Moderimi i qëndrimit agresiv të Serbisë ndaj Kosovës zuri vendin e dytë në përpjekjet për të bindur Beogradin të ndryshojë qëndrimin e tij pro-Rusisë. Mendimi i përgjithshëm është se Kurti i keqmenaxhoi marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara dhe ndoshta shpërdoroi mundësinë më të mirë që pati gjatë periudhës së tij si kryeministër për të çuar përpara ndjeshëm interesat e vendit të tij. Ndërsa veprimet e tij dëmtuan marrëdhëniet e veçanta të Kosovës me Shtetet e Bashkuara, ato nuk duket se e kanë përmirësuar në mënyrë të matshme pozitën e Kosovës. Autoriteti i Prishtinës në veri mbetet i dobët dhe integrimi i serbëve mund të jetë bërë edhe më i vështirë. Sot, marrëdhënia ShBA-Kosovë është në një pikëkthesë të rëndësishme. Administrata e re Trump dhe zgjedhjet e fundit në Kosovë paraqesin si sfida, ashtu edhe mundësi për të kthyer marrëdhëniet ShBA-Kosovë në rrugën e duhur. Kosova përballlet me një situatë të re gjeo-politike, e cila nuk është domosdoshmërisht në favor të saj. Pikëpamja e Presidentin Trump për politikën e jashtme është transaksionale. Ai ka sjellë ndryshime të thella në kursin e politikës amerikane. Përmirësimi i marrëdhënieve midis Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë, diplomacia shtrënguese që po ushtrohet ndaj Ukrainës për të bërë lëshime ndaj Moskës, dhe ndërrime të tjera në strategjinë amerikane sinjalizojnë një largim nga agjenda e mëparshme e Uashingtonit për nxitjen e demokracisë, luftën kundër ndikimit të Rusisë në Ballkan, dhe të sfidimit të autoritarizmit në rritje në rajon. Administrata Trump ende nuk ka formuluar një strategji të qartë ndaj Ballkanit dhe mbetet për t'u parë nëse Kosova do të jetë në qendër të vëmendjes së administratës. Mesazhi i Presidentit Trump drejtuar presidentes Vjosa Osmani, me rastin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës ishte mesazh pozitiv. Ai shprehu mbështetje të plotë për Kosovën dhe tha se Shtetet e Bashkuara "mezi presin të ndërtojnë një marrëdhënie më produktive me qeverinë e Kosovës gjatë vitit të ardhshëm". Por Kosova mbetet shumë e prekshme nga ndryshimi i politikës amerikane dhe peizazhi i ri gjeo-politik. Serbia tashmë ndihet e inkurajuar nga kthimi i Presidentit Trump në Shtëpinë e Bardhë. Në një fjalim në një tubim në Mitrovicën e Sremit me rastin e Ditës së Shtetformimit të Serbisë, më 15 shkurt, Vuçiqi përdori një ton agresiv. Ai deklaroi se Kosova ishte "pjesë e territorit tonë" dhe pretendoi se protestat tre-mujore studentore u nxitën nga të huajt sepse ai refuzoi të "kapitullonte" mbi çështjen e Kosovës. Ai denoncoi

në mënyrë specifike USAID-in dhe Fondin Kombëtar për Demokraci (National Endowment for Democracy) për gjoja organizimin e një "revolucionit ngjyrash" që synonte rrëzimin e tij nga pushteti. Vuçiqi mund të përpiqet të përdorë çështjen e Kosovës për të larguar vëmendjen nga trazirat e brendshme në rritje nëpërmjet incidenteve provokuese në veri dhe duke këmbëngulur me kërkesat e tij për një marrëveshje të ngjashme me atë të Dejttonin. Kosovës i mungon kapaciteti për të mbrojtur sigurinë e vet dhe nuk mund ta marrë më si të mirëqenë se KFOR-i do të mbronte sovranitetin dhe integritetin territorial të saj. Zgjedhjet e fundit të Kosovës, megjithatë, ofrojnë një mundësi. Situata e re kërkon një udhëheqje të pjekur që është në gjendje të ndërmarrë veprime konkrete dhe të qëndrueshme për të rivendosur marrëdhëniet e njollosura të Kosovës me Shtetet e Bashkuara dhe për të kërkuar ndihmën e Uashingtonit në arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë që e forcon sovranitetin e saj. Kjo e bën të nevojshme formimin e shpejtë të një qeverie të re. Pavarësisht se kush e formon qeverinë e ardhshme, Kurti apo forcat opozitare, Kosova ka nevojë për një marrëveshje ndërpartiake për të zhvilluar një politikë koherente. Ajo gjithashtu ka nevojë që në poste të rëndësishme të kabinetit të emërohen zyrtarë pragmatikë, me peshë dhe që kanë aftësitë e nevojshme për tu përballuar me situata të ndërlikuara. Në të kaluarën, mungesa e konsensusit për çështje themelore ka dëmtuar qëndrimin e Kosovës dhe ka krijuar keqdashje në radhët e mbështetësve të saj më të fortë. Duke pasur parasysh pasiguritë që lidhen me ndryshimet e tanishme strategjike dhe faktin se Kosova po vepron nga një pozitë më e dobët, forcave kryesore politike të vendit do t'u duhet të lënë mënjanë interesat e tyre të ngushta politike, të zhvillojnë një qëndrim të përbashkët mbi çështjet thelbësore dhe të hartojnë një rrugë të qartë përpara. Emërimi i përfaqësuesit të ri special të BE-së për dialogun Kosovë-Serbi paraqet një mundësi për një fillim të ri. Por një marrëveshjeje midis Kosovës dhe Serbisë që do të shpinte në njohje të ndërsjellë nuk ka gjasa në mungesë të një angazhimi intensiv diplomatik amerikan. Shtetet e Bashkuara kanë bërë investime të mëdha në Kosovë dhe tani do të duhej ta ndihmonin Kosovën të arrijë më në fund objektivat për të siguruar sovranitetin e saj të plotë dhe për të arritur një paqe të qëndrueshme me Serbinë. Uashingtoni ka besueshmërinë dhe aftësinë për të ndihmuar Kosovën të formësojë të ardhmen e saj. Një Kosovë sovraane, e qëndrueshme, e begatë dhe demokratike është në interesin kombëtar të ShBA-së.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova U17 pëson humbje nga Turqia

Përfaqësuesja U17 e Kosovës në hendboll e ka zhvilluar ndeshjen e parafundit në

Kampionatin Mesdhetar në Podgoricë të Malit të Zi. Të enjten në mesditë vashat e reja

“dardane” luajtën me Turqinë, kurse pësuan me rezultat 28:18. Pjesa e parë dhe e tretë

ishin thuajse të barabarta, kurse dallimi u bë në të dytën. Të premtën Kosova luan

ndeshjen e fundit në fazën grupore dhe përballet me Kroacinë nga ora 12:00.

‘Dardanet’ synojnë fitore ndaj Maqedonisë së Veriut



“Epoka e re”

PRISHTINË, 20 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e vajzave ka përmblytur përgatitjet për ndeshjen e parë në edicionin e ri të Ligës së Kombeve. Skuadra e drejtuar nga përzgjedhësi Sami Sermahaj ka zhvilluar të enjten seancën e fundit stërvitore në Kampin Nacional në Hajvali përpara sfidës kundër Maqedonisë së Veriut e cila luhet sot (e premte) në Shkup, në kuadër të Grupit 6 të Ligës C. Në këtë stërvitje përzgjedhësi Sermahaj dhe stafi i tij kanë punuar për hollësi taktike, derisa gjatë tri ditëve stërvitje “dardanet” kanë punuar me

përkushtim maksimal për ta nisur këtë cikël me rezultat pozitiv dhe për ta bërë hapin e parë drejt objektivit kryesor - rikthimit në Ligën B. Pas stërvitjes, dy lojtare të Kosovës, Blerta Smaili dhe Djellza Mehmeti, ndanë pritshmëritë e tyre për këtë sfidë. “Besoj që jemi përgatitur shumë mirë. Kemi ushtruar tri ditë me intensitet. Atmosfera është shumë e mirë në ekip dhe shpresojmë në fitore. I kemi pasur përballë disa herë këta kundërshtarë kohën e fundit dhe kemi fituar, por kjo nuk do të thotë se do të jetë një ndeshje e lehtë. E marrim si çdo ndeshje tjetër me seriozitet maksimal. Synojmë të kthehemi në Ligën B dhe po punojmë për realizimin e këtij

objektivit”, ka thënë futbollistja Blerta Smaili. Për këtë ndeshje foli edhe Djellza Mehmeti: “Është një ndjenjë shumë e mirë. Të kalosh nga grupmosha U19 në ekipin e parë është thjesht ndjenjë e papërshkrueshme. Është kënaqësi dhe privilegj të jesh pjesë e Kombëtares A me këto vajza të mrekullueshme, të cilat kanë treguar sukses. Në bazë të stërvitjeve dhe harmonisë së ekipit, besoj se do të dalim me rezultat pozitiv në ndeshjen me Maqedoninë e Veriut”. Ndeshja Maqedoni e Veriut - Kosovë zhvillohet sot në orën 14:00 në Shkup, ndërsa sfidën e dytë “dardanet” do ta luajnë në stadiumin “Fadil Vokrri” kundër Letonisë.

SHKURT

UEFA delegon Rita Vehapin për ndeshjen Luksemburg - Kazakistan

UEFA e ka deleguar Rita Vehapin gjyqtare kryesore për ta ndarë drejtësinë në ndeshjen kualifikuese të Ligës së Kombeve në kategorinë e vajzave, Luksemburg-Kazakistan. Në ndeshjen që do të zhvillohet në stadiumin “Emile Matrisch” në Esch-sur-Alzette, gjyqtaren Vehapi do ta asistojnë Lumturije Muhadri dhe Fitore Govori, ndërsa gjyqtarja e katërt do të jetë Festin Koxha. Kjo ndeshje do të zhvillohet të premtën, më 21 shkurt, me fillim në orën 19:30.

Myrto Uzuni paraqitet te FC Austin

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Myrto Uzuni, është paraqitur në klubin e MLS-së, FC Austin. Uzuni ka marrë fanellën me numrin 10 dhe është gati për aventurën amerikane. Pasi është paraqitur para medieve, ka mbajtur edhe një fjalim. “Të jem i sinqertë, përpara se të firmosja folëm me drejtuesit dhe kuptova që kemi tifozë shumë të mirë. Është një nga ekipet që i shiten të gjitha biletat në çdo ndeshje. Ashtu siç thashë më parë, unë do ta jap maksimumin, pasi këta njerëz vijnë ta mbështesin Austinin, kështu që puna ime është t’i bëj të lumtur tifozët duke shënuar gola sigurisht”, ka thënë Uzuni.

Ballkani ndan rrugët me Enea Koliçin

Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Ballkani, ka njoftuar se i ka ndarë rrugët me portierin Enea Koliçi. Klubi nga Suhareka e ka falënderuar portierin në fjalë dhe i ka uruar suksese në të ardhmen. “Me marrëveshje të dyanshme kemi arritur pajtim me portierin Enea Koliçi ta mbyllim ciklin e bashkëpunimit. Me konsideratë të thellë dhe falënderim për kontributin e tij të madh në sukseset tona, Eneas i urojmë më të mirat në jetë dhe suksese në futboll. Emri i Koliçit tashmë është gdhendur në trofetë e përbashkëta e në rrugëtimet tona evropiane, sikurse edhe në zemrat e tifozëve tanë. Faleminderit kampion!”, thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Astrit Hasani emërohet këshilltar i KOK-ut për marrëdhënie ndërkombëtare

PRISHTINË, 20 SHKURT - Bordi Ekzekutiv i KOK-ut në mbledhjen e parë të ciklit olimpiq 2021-2025 ka votuar unanimisht për propozimin e presidentit Ismet Krasniqi për emërimin e dr. Astrit Hasani, këshilltar i KOK-ut për marrëdhënie ndërkombëtare. Ish-kryetari i Federatës së Peshëngritjes së Kosovës është arkëtar (thesar) dhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të Federatës Evropiane të Peshëngritjes që nga viti

2016. Momentalisht është kandidat për president të Federatës Evropiane të Peshëngritjes me mbështetje të plotë nga KOK-u. Hasani ka shkollim superior - magistraturë - në Universitetin e Kembrixhit dhe doktoratë në Universitetin e Varshavës. Është i njohur në Federatën Botërore të Peshëngritjes për qëndrimin e tij që sporti është mbi politikën. Atij i ishte besuar pozita e CEO-s për organizimin e

Kongresit Zgjedhor të Federatës Botërore të Peshëngritjes, të mbajtur në vitin 2022 në Tiranë të Shqipërisë, organizim që më vonë organizata “Albanian Excellence” i dha çmimin “The Grand Excellence Award”. Po ashtu, për shkak të kontributit në peshëngritjen evropiane, vitin e kaluar në Varshavë të Polonisë në Kongresin Evropian, pranoi çmimin e madh evropian “Ylli i Artë”.



Guardiola: Dua të vazhdoj me Cityn

MANCHESTER, 20 SHKURT - Manchester City u eliminua nga Liga e Kampionëve pas një humbjeje të thellë nga Real Madridi në "Santiago Bernabeu", 1-3. Pas formës së dobët të ekipit në këtë edicion po spekulohet

gjithnjë e më shumë për një largim të mundshëm të trajnerit Pep Guardiola, mirëpo spanjollit insiston se nuk e ka ndër mend të lëvizet nga "Etihad Stadium". Madje po mendon qysh tash për sezonin e ardhshëm. "Nuk e

di nëse është pyetja e duhur në këtë moment. Për ta fituar Ligën e Kampionëve fillimisht duhet të kualifikohesh dhe më pas të përballësh me krejt rrugëtimin. Ishim me fat që morëm pjesë në këtë

kompeticion për shumë vjet, ta fitonim një herë dhe të arrinim në finale. Në këtë vit nuk kemi qenë mjaftueshëm afër, të shohim se çfarë do të ndodhë në të ardhmen", ka deklaruar Guardiola për "TNT Sport".



Mbappe: Dua ta shkruaj historinë e Realit

MADRID, 20 SHKURT - "Nuk erdha këtu për të luajtur keq, por dua të luaj mirë. Dua të bëj epokë dhe ta shkruaj historinë e Real Madridit. Duhej të luaja me personalitet. Koha e përshtatjes ka mbaruar dhe tani duhet t'i tregoj cilësitë e mia". Kurrë më parë Kylian Mbappe nuk kishte dhënë një deklaratë kaq të qartë, të drejtpërdrejtë dhe mbresëlënëse që nga momenti kur zbkoi në "planetin" Real Madrid, pas largimit nga Paris Saint-Germaini. Këtë e tha në një intervistë për "CBS Sports Golazo", duke lënë të kuptohet se është gati të bëjë histori me "Los Blancos". Tripleta e tij kundër Manchester Cityt në ndeshjen e kthimit të "play-off"-it të Ligës së Kampionëve, që përfundoi 3-1 në "Santiago Bernabeu", jo vetëm eliminoi Guardiolen dhe ekipin e tij nga turneu prestigjioz, por i dha Mbappes çmimin "UEFA Man of the Match" dhe vulosi kualifikimin e Real Madridit në 1/8 finale. E veçanta? Francezi



mori pjesë në golin e tij të 500-të në karrierë, një moment historik i arritur në moshën vetëm 26-vjeçare. Sulmuesi francez, me dy golat e parë të shënuar, arriti një moment historik të rëndësishëm. Siç raportohet nga ekspertët e statistikave në Opta, në moshën 26 vjeç e 61 ditë, ish-lojtari i Paris Saint-Germainit. Ka marrë pjesë me 500 gola midis klubeve dhe kombëtares, në të gjitha kompeticionet (358 gola dhe 142 asistime), më pas ai e çoi këtë numër në 501, duke u

konfirmuar si një nga futbollistët që bëjnë histori. Pas një periudhe përshtatjeje në skemat e Carlo Ancelottit, ylli francez është në një formë të jashtëzakonshme. Këtë e konfirmoi edhe Jude Bellingham në një intervistë për "TNT Sports": "E di që fillimi i tij nuk ishte i lehtë, iu desh kohë të përshtatej me këtë realitet të ri. Tani po rritet dhe përmirësohet çdo ditë e më shumë. Është fantastike ta shohësh në këtë formë. Është një ndjenjë e pabesueshme të luash me të. Kur zbresim në fushë, e dimë se mund t'i japim topin dhe ai do ta bëjë dallimin. Detyra jonë, si mesfushorë, është ta ndihmojmë atë dhe sulmuesit e tjerë të jenë në pozitë më të mira për ta vendosur ndeshjen. Kur Kylian merr topin në zonat e tij të pëlqyera, bëhet i pandalshëm, si me të majtën, ashtu edhe me të djathtën. Sot (dje) shënoi gola të çdo lloji. Ajo që ka arritur në karrierën e tij është thjesht e pabesueshme".

Leclerc: Shpresoj që ky të jetë viti i duhur për Ferrarin

MARANELLO, 20 SHKURT - Sezoni 2025 në Formula 1 është në prag: Së shpejti skuadrat do t'i kryejnë testet e vetme dimërore dhe pas gati 3 javësh, në Melburn do të zhvillohet gara e parë sezonale. Një kampionat ku te Ferrari kanë pritshmëri të mëdha, sidomos pas ardhjes së Lewis Hamiltonit. Pas prezantimit të makinës në Londër dy ditë më parë, pilotët e "kokëkuqes" janë rikthyer në Maranello, ku dhe kanë testuar makinën e re, duke shfrytëzuar 100 km e lejuara nga FIA për xhirime. Piloti monegask Charles Leclerc ka pritshmëri të larta nga ky sezon i ri. "Dëshira ime për t'u bërë kampion bote është gjithmonë e njëjtë sepse e dua atë që bëj, mbi të gjitha e dua Ferrarin dhe



dua të fitoj me Ferrarin. Të fitosh titullin këtu do të ishte një gjë absolutisht e pabesueshme dhe po bëj gjithçka që mundem për ta bërë sa më shpejt që të jetë e mundur realitet", ka thënë Leclerc. "Shpresoj që ky të jetë viti i duhur. Të gjithë në ekip punuam si të çmendur për të siguruar që të mbërrinim në testet e para javën e ardhshme në Bahrein sa më të gashëm. Ndaj pritshmëritë mbeten të

larta. Do të zhgënjehesha nëse nuk fitojmë të paktën një nga dy titujt. Vitin e kaluar ne përfunduam në vendin e dytë në kampionatin e konstruktorëve dhe isha shumë i zhgënjyer. Pra, synimi do të jetë fitorja, që është gjithmonë ambicie te Ferrari. Kështu që do të isha i zhgënjyer në fund të vitit nëse nuk do të kishte dy tituj, por do të bëjmë gjithçka për ta bërë realitet këtë ëndërr", ka shtuar Leclerc. Në fund, piloti i "kokëkuqes" ka shtuar: "Jemi një dyshe e fortë pilotësh. Dyshja e Ferrarit është gjithmonë më e mira, por do të duhet të dëshmojmë në pistë nëse jemi edhe më të fortët. Lewisi e ka treguar tashmë, duhet t'u tregoj të gjithëve se do të jem dhe po punoj shumë".

SHKURT

Muslija kthehet nga lëndimi

Florent Muslija është kthyer nga lëndimi që e mbajti jashtë për pothuajse një muaj. Mesfushori i Kosovës e kishte lënduar kyçin e këmbës, ndërsa të mërkurën zhvilloi stërvitje për herë të parë me lojtarët e tjerë të Freiburgut. Por, paraqitja e tij në ndeshjen kundër Werder Bremenit të premten nga ora 20:30 është në dyshim. Muslija 26-vjeçar ka luajtur vetëm 160 minuta për Freiburgun në Bundesligë këtë edicion. Ai është prej lojtarëve më të rëndësishëm të Kosovës dhe pritet të jetë i gatshëm për ndeshjet me Islandën në muajin mars.

Mourinho: Legjendari për mua është Ranieri

Trajneri Jose Mourinho ka dhënë deklarata të papritura gjatë një interviste në podcastin e ish-mesfushorit John Obi Mikel. Kur u pyet se kë pëlqente mes Sir Alex Fergusonit dhe Pep Guardiols, "Special One" shmangu krahasimin e drejtpërdrejtë, duke theksuar se është e pamundur të krahasohen epoka dhe kontekste të ndryshme: "Të dy janë trajnerë historikë në Premierë Ligë, por më legjendari për mua është Ranieri". Mourinho shpjegoi arsyen e zgjedhjes së tij, duke njohur arritjen e jashtëzakonshme të trajnerit italian me Leicester Cityn: "Të fitosh 5 ose 6 trofe me Manchester Unitedin ose Manchester Cityn në këtë brez është një arritje e madhe, por ta çosh Leicesterin drejt titullit është diçka unike. Nuk ka 'por': ishte trofeu më i pabesueshëm që kam parë dhe përjetuar ndonjëherë".

Ancelotti: Jam krenar për ekipin tim

Pas fitores 3-1 të Real Madridit ndaj Manchester Cityt dhe kualifikimit bindës në 1/8 finale të Ligës së Kampionëve, trajneri Carlo Ancelotti u shpreh krenar me skuadrën e tij. "Kemi zhvilluar një ndeshje të shkëlqyer kundër një kundërshtari të fortë si Manchester City. Jam krenar për skuadrën time; treguam karakter dhe cilësi në fushë. Mbappe ishte i jashtëzakonshëm me tripletën e tij, por e gjithë skuadra kontribuoi në këtë fitore të rëndësishme. Tani duhet të përqendrohemi në ndeshjet e ardhshme dhe të vazhdojmë me këtë ritëm", ka thënë Ancelotti.

Slot: Nuk jam i kënaqur me këtë barazim

Liverpooli luajti baras me Aston Villan në Premierë Ligë (2-2). Ky rezultat nuk i pëlqeu aspak trajnerit Arne Slot, i cili ka thënë se "Reds" e lejoi kundërshtarin të zhvillojë lojë të mirë në pjesën e dytë. "Nuk jam i kënaqur me këtë barazim. Lejuam skuadrën kundërshtare të luante mirë në pjesën e parë, prandaj edhe u ndëshkuam me dy gola. Më pas çdo gjë u bë e vështirë. Rasti në fund i Nunezit? Ndihej i keqardhur. Ishte një rast shumë i pastër shënimi, që erdhi nga një aksion i ndërtuar mjaft mirë prej skuadrës sonë", ka thënë Slot. Liverpooli me këtë barazim ngjitet në kuotën e 61 pikëve, duke e çuar dallimin me ndjekësen më të afërt Arsenalin në +8 pikë.

Motta: Eliminimi, pjesë e lojës dhe punës sonë

Juventusit u turpërua në Ligën e Kampionëve, duke u eliminuar nga PSV-ja pas kohës shtesë. Seria A shpresonte të shkonte me pesë ekipe sezonin e ardhshëm në Ligën e Kampionëve, por eliminimi i

tre ekipeve që në fazën e Ligës e bën thuajse të pamundur këtë përfundim. Trajneri i bardhezinjve, Thiago Motta, nuk e bën dramë këtë eliminim. "PSV-ja nuk e dëshironte më shumë

kualifikimin sesa ne. Pas golit të barazimit, ata shtynë më shumë, krijuan më shumë, ishin superiorë. As ne nuk qëndruam pasivë, kishim rastet tona, si me Vlahović në fund. Në përgjithësi ishte një

ndeshje e hapur dhe e luftuar. Gjithsesi, tani është koha të shohim përpara. Që nga kjo e diel kemi një ndeshje të rëndësishme në kampionat kundër Cagliariarit. Në Ligën e Kampionëve ka një nivel të

lartë. Ne hasëm shumë vështirësi. Nuk na mbetet gjë tjetër vetëm të menaxhojmë këtë humbje. Na vjen shumë keq për këtë eliminim, por dhe kjo është pjesë e lojës, e punës sonë", u shpreh Motta.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Guri i Bekuar" shpk, Hani i Elezit, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Zgjerimin e Zonës së Eksploatimit të Gurit Gëlqeror në Seçishtë, Hani i Elezit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.04.2025 në ora 10:00 në objektin e Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët "Ilaz Thaçi", Hani i Elezit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Guri i Bekuar" shpk, Hani i Elezit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën. Debatin Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwvrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Guri i Bekuar" shpk, Hani i Elezit, për Zgjerimin e Zonës së Eksploatimit të Gurit Gëlqeror në Seçishtë, Hani i Elezit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Adresa: rr.Ibrahim Krasniqi Prishtinë lurnshpk@gmail.com Nr tel: 045510011&46 143401&45 690 141

Prishtinë, 13.02.2025

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 810084062 me adresë: Rr. „Ibrahim Krasniqi“ nr. 10, Komuna e Prishtinës Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.01.2025 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej 483.12 kW ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës.

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 483.12 kW ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.3861-2/23 dt. 23.10.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Njoftimi nr. 07-350/02-0032027/23 dt. 10.05.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimi për Kushte Ndërtimore Nr. 07-0350/04-0085583/23 dt. 12.02.2024 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: Nr. 07-351/02-0044941/24 të datës 29.11.2024 për "Ndërtimin e Parkut të Energjisë Solare Fotovoltaike me kapacitet prej 483.12 kW, ZK Shajkoc, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Pëlqimin Elektroenergetik Nr. 19358 dt.20.10.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Deklarimet financiare;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC)
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut. Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: lurnshpk@gmail.com dhe LEGAL-LENCING@ero-ks.org Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Adem Arifi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

Redon Albert Koshi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII dhe diplomën e sh.m.l.e "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Rizo Hodaj nga Kabashi KK Prizren shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.a.t. "Abdyl Frashëri" Prishtinë Bukëpjekës.

- Dulë Gjuraraj Gerqinë KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Aroni DF" SH.P.K. shpall të pavlefshme numrin unik identifikues të biznesit 812228824 lëshuar nga ARBK.

Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Kongresi i Manastirit" Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe -6-9

- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 5 dhe 7 i Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të punës: Udhëheqës/e i/e Zyrës Ligjore (1) pozitë
I raporton: Sekretarit të Përgjithshëm të OMK-së
Niveli i pagës: 7.76
Orët e Punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e Kontratës: Kohë të pacaktuar
Vendi Punës: "Instituti A" QKUK, 10 000 Prishtinë

Detyrat e përgjithshme:

- Koordinon, menaxhon dhe mbikëqyr punën e Zyrës Ligjore të OMK-së;
- Ofron udhëzime dhe këshilla profesionale në kuadër të Zyrës Ligjore;
- Harton dhe zhvillon legjislacion, akte normative si dhe akte të tjera juridike, kontrata, marrëveshje të cilat dalin nga fushëveprimtaria e OMK-së në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Monitoron ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës;
- Siguron që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të përgatitura nga ZL të jetë sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik;
- Drafton opinione/memorandume/përmbledhje ligjore në çështje të ndryshme ligjore kërkuar nga organet e ndryshme me aktivitetet e Odës;
- Bën hulumtime dhe analiza të ndërlidhura me ligjet dhe aktet nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për stafin dhe organet e OMK-së;
- Harton raportet e punës të Zyrës Ligjore;
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesave të Sekretarit të Përgjithshëm në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme si dhe aktet e brendshme të OMK-së.

Kualifikimet:

- Të jetë i diplomuar në Fakultetin Juridik, apo të avancuar (studime master);
- 2 (dy) vite përvojë pune menaxheriale;
- Preferohen kurse dhe trajnime gjatë karrierës profesionale;

Aftësitë:

- Plotëson kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj dhe Statut të OMK-së;
- Njohja e gjuhës angleze e obligueshme;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punës;
- Të ketë shkathtësi në përcaktimin dhe arrijen e objektivave strategjike të institucionit, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negociimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri të standardeve të integritetit, ndershmërisë dhe drejtësisë;

Mënyra e aplikimit;

Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike në adresën: info@omk-rks.org

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkëngjiten:

- Aplikacioni i OMK-së [Formulari i aplikimit](#)
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Konkursi publik është i hapur deri më 07.03.2025;
- Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
- Faza e testit me shkrim 10 ditë pas fazës së verifikimit;
- Faza e intervistës deri në 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim;
- Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Shënim: Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit;

- Vlerësimi i kandidatëve zhvillohet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistimit (testim me gojë);
- Testi me shkrim - maksimumi 70 pikë;
- Intervista - maksimumi 20 pikë
- Jetëshkrimi - maksimumi 10 pikë.

Oda e Mjekëve të Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Shpallja është e hapur që nga data 20.02.2025 deri më 07.03.2025 në ora 23:59.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel.: 049/872-300 apo 038/544-872.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Na osnovu člana 57. Zakona br. 04/L-150 o komorama zdravstvenih radnika, člana 8. Zakona br. 03/L-212 o radu, kao i člana 5. i 7. Administrativnog uputstva (MFRT) br. 01/2024. o regulisanju postupaka za osnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, Lekarska komora Kosova raspisuje ovaj:

KONKURS

o popunjavanu radnog mesta

Naslov radnog mesta: Rukovodilac/teljka Pravne kancelarije, jedno (1) radno mesto
Izveštava: Generalni sekretar Lekarske komore Kosova
Nivo plate: 7.76
Radno vreme: 40 sati nedeljno
Trajanje ugovora: Na neodredeno vreme
Radno mesto: "Institut A" KUCK, 10 000 Prishtina

Opšte dužnosti:

- Koordinira, upravlja i nadgleda rad Pravne kancelarije LKK-a;
- Daje stručna uputstva i savete u okviru Pravne kancelarije;
- Izrađuje i sprovodi zakonodavstvo, normativne akte i druge pravne akte, ugovore, sporazume koji proističu iz delokruga LKK-a, na osnovu postupaka koji su utvrđeni u skladu sa važećim zakonodavstvom;
- Prati primenjive zakone Republike Kosova;
- Obezbeđuje da sadržaj i forma normativnog akta koje priprema PK budu što tačniji, kako sa jezičkog tako i sa tehničkog aspekta;
- Izrađuje pravna mišljenja/memorandume/sazetke o različitim pravnim pitanjima koje traže različiti organi u vezi sa aktivnostima Komore;
- Sprovodi istraživanja i analize u vezi sa zakonima i podzakonskim aktima u okviru delokruga i daje preporuke, savete i uputstva osoblju i organima LKK-a;
- Izrađuje izveštaje o radu Pravne kancelarije;
- Obavlja i druge dužnosti na zahtev Generalnog sekretara u skladu sa primenjivim zakonima i uredbama kao i unutrašnjim aktima LKK-a.

Kvalifikacije:

- Da je diplomiran na Pravnom fakultetu ili naprednim studijama (master studije);
- 2 (dve) godine radnog isustva na rukovodećim funkcijama;
- Poželjni su kursevi i obuke tokom stručne karijere;

Sposobnosti:

- Da ispunjava i opšte uslove predviđene Zakonom i Statutom LKK-a;
- Poznavanje engleskog jezika je obavezno;
- Poznavanje rada na računaru sa potrebnim softverom za obavljanje poslova.
- Da poseduje veštine u postavljanju i ostvarivanju strateških ciljeva institucije, visoke organizacione i liderske veštine, odlične komunikacione i pregovaračke veštine, dokazane veštine analize situacije i nudenja opcija, poznavanje standarda integriteta, poštenja i pravde;

Način apliciranja:

Apliciranje se vrši samo elektronskim putem na adresu: info@omk-rks.org

Kandidati koji konkurišu moraju tačno napisati adresu, broj kontakt telefona kao i email adresu. Samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa biće pozvani na dalje postupke zapošljavanja.

Dokumenti koji se trebaju priložiti:

- Aplikacija LKK-a [Formular apliciranja](#)
- Kopija lične karte;
- Kopija diplome zahtevane konkursom izdate od obrazovnih institucija Republike Kosova. Ako je diploma stečena izvan zemlje, potvrda o nostrifikaciji stečene diplome ili akt koji dokazuje da je stečena diploma u postupku nostrifikacije, pod uslovom da se nostrifikacija diplome podnosi do momenta potpisivanja akta za imenovanje na poziciji;
- Kopije dokaza o zaposlenju (potvrda/ugovor) izdate od odgovarajuće institucije za zapošljavanje za radno iskustvo, koje utvrđuju radnu poziciju kao i trajanje angažovanja na toj poziciji. Dokaz o zaposlenju van javnih institucija mora biti potkrepjen najmanje jednim od dokaza kao u nastavku: izveštaj plaćanja u penzijski štedni fond ili izveštaj plaćanja poreskih obaveza u skladu sa zakonodavstvom o porezu na lične prihode.
- Dokaz o pohanjanim stručnim obukama ili obukama koje je aplikant realizovao u svojstvu trenera.

Približni kalendar postupka zapošljavanja:

- Javni konkurs je otvoren do dana 07.03.2025;
- Faza prethodne verifikacije aplikacija do 7 dana;
- Faza pismenog testa 10 dana nakon faze verifikacije;
- Faza intervju do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa;
- Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon ocenjivanja intervjuja.

Beleška: Aplikacije koje pristigu nakon roka utvrđenog u konkursu i one nepotpune sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Način ocenjivanja i kriterijumi bodovanja:

- Ocenjivanje kandidata se odvija putem pismenog testiranja i intervjuisanja (usmeno testiranje);
- Pismeni test - maksimalno 70 bodova;
- Intervju - maksimalno 20 bodova;
- Životopis - maksimalno 10 bodova.

Lekarska komora Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljanke Republike Kosova i pozdravlja aplikacije od svih lica muškog ili ženskog pola i svih zajednica u Republici Kosova.

Oglas je otvoren od dana 20.02.2025 deri më 07.03.2025 u 23:59 časova.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na br. tel.:049/872-300 ili 038/544-872.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

